

Bugajski: Si do të përmblihdhni politikën e Sigurisë Kombëtare të Shqipërisë. Pra, në parim, cilat janë kërcënimet, sfidat, qëndrimet e detyruara dhe mundësitë?

Kodheli: Shqipëria u bë anëtare e NATO në prill 2009 dhe kjo ngjarje shënon historinë tonë, ashtu siç shënon dhe vitet e ardhshme. Sepse kjo ishte një zhvendosje themelore nga strategjia individuale e Mbrojtjes dhe Sigurisë drejt një strategjie kolektive. Ne kemi patur një ushtri të madhe në epokën e komunizmit, shumë prona, me një numër të madh krahasuar me numrin e popullatës dhe me municione të shumta, kjo ka ndikuar mënyrën se si ushtria shqiptare do të donte të transformohej dhe se si do të transformohet, duke respektuar dhe përmbushur obligimet e NATO, strategjinë e NATO dhe, natyrisht, duke përmbushur strategjinë e sigurisë tonë kombëtare, sigurinë e vendit tonë, politikën e mbrojtjes së civilëve tanë e të trashëgimisë sonë dhe, sigurisht, mënyrën se si ne po përkrahim anëtarësimin e vendeve të Ballkanit për të qenë pjesë e NATO, ku, siç e dini, vetëm Kroacia është anëtare e NATO në këtë moment dhe, sigurisht, për të mbështetur Kosovën për t'u transformuar nëpërmjet të njëjtës rrugë duke qenë një anëtare e BE dhe e NATO. Dhe të gjithë së bashku të kemi një rajon më të sigurtë dhe më demokratik, dhe, pse jo, edhe më global.

E dyta, është se si një vend anëtar i NATO sot, ne kemi shumë detyrime për të përmbushur. Ne kemi tashmë trupa që luftojnë në Afganistan, në kuadër të ISAF. Dhe më vonë ne do të mbështesim forcat afgane të sigurisë që ato të mësojnë se si të mbrojnë demokracinë e tyre të brishtë dhe qytetarët e tyre në të ardhmen më të afërt. Më parë ne kemi qenë thjesht një mbështetje për batalionet apo brigadat luftuese, tani jemi në frontin e parë, dhe më vonë, ne, si trupa shqiptare, do të mbështesim forcat afgane të sigurisë. Këto janë hapa shumë të mirë nëpërmjet një ushtrie më efikase, më të përgatitur dhe më profesionale, ashtu siç ushtria shqiptare do të donte të ishte në të ardhmen e afërt. Ne kemi disa forca speciale dhe kemi bërë modernizime, po orvatemi të depolitizojmë ushtrinë, por ky është një proces, nuk është diçka që ne mund ta bëjmë sa hap e mbyll sytë. Ministria e Mbrojtjes, nën Qeverinë Rama, ka për të punuar në drejtime të ndryshme për të bërë që gjërat të funksionojnë më mirë, dhe, natyrisht, për të siguruar qytetarët shqiptarë që ata do jenë të mbrojtur më mirë se më parë, që ata të gëzojnë mbështetje dhe se, kësodore, demokracia dhe sundimi i ligjit mund të funksionojnë më mirë dhe e ardhmja e fëmijëve të tyre mund të jetë më e mirë.

Ministria e Mbrojtjes dhe politikat e Qeverisë së Shqipërisë janë pjesë e këtij konteksti. Ne duhet ta udhëheqim këtë proces.

Bugajski: Dua të kalojmë në çështjen më të gjerë të NATO, përfshirë dhe post-Afganistanin, mbas disa minutash, por më lejoni t'ju pyes gjerësisht mbi Rishikimin Strategjik të Mbrojtjes, që u përmbyll vitin e kaluar. Hapi tjetër është Plani për Zbatimin nga Ministria e Mbrojtjes. Cili është plani juaj, dhe, ç'është më e rëndësishmja, si do të preket ai nga buxheti i Mbrojtjes, sepse, siç e dini, situata financiare që qeveria e re gjeti nuk është fort e shëndetshme. Si do të ndikojë kjo në jetësimin e doktrinës strategjike?

Kodheli: Në Parlament, Rishikimi Strategjik i Mbrojtjes u miratua këtë vit. Ky është një dokument tejet strategjik mbi të cilin ne do të ndërtojmë strategjinë tonë mbrojtëse. Por, natyrisht, ne na duhen para për ta jetësuar atë, dhe kjo s'është periudha më e mirë, nga pikëpamja financiare. Përkundrazi. Unë kam një arsimim dhe një të kaluar si ekonomiste dhe financiere dhe e di përse bëhet fjalë më shumë se sa të tjerë njerëz. E vërtetë! Ne kemi gjetur një nga skenarët më të këqij, ku Shqipëria ka qenë gjatë dy dekadave të fundit. Më e keqja ishte në vitin 1997, me

skemat piramidale, dhe tjetra është e tashmja. Kam parë të dhënat dhe, në fund të vitit, ne kemi për të patur gjithnjë e më pak të ardhura. Nga 25.3% e PBB (Prodhimi i Brendshëm Bruto), të ardhurat do të shkojnë në 23.8% dhe kjo është një shumë e madhe parash, gjë që do të thotë se ne do të kemi shkurtime në të gjithë sektorët dhe kjo natyrisht do të prekë edhe Ministrinë e Mbrojtjes, por ne gjithsesi do të përmbushim obligimet tona ndaj NATO. Më e rëndësishmja është të kemi përpjesëtime të mira kur të hartojmë buxhetin. Detyrimet ndaj stafit në paga; zbatimin e shpenzimeve të mirëmbajtjes dhe atyre operacionale dhe shpenzime të tjera, natyrisht, kanë për të ndihmuar ushtrinë shqiptare dhe Ministrinë e Mbrojtjes të përmbushin dhe të respektojnë plotësisht Rishikimin Strategjik të Mbrojtjes, i cili është një aspekt kyç jo vetëm i politikës sonë ushtarake, por edhe i politikës sonë të jashtme. Në këtë rast, ne do të orvatemi fort të shkurtojmë shpenzimet që nuk na duhen.

E dyta, të përdorim në mënyrë efikase paratë që kemi.

E treta, e fundit, por jo më pak e rëndësishmja - madje përkundrazi më e rëndësishmja - të luftojmë korrupsionin.

Bugajski: Sapo do t'ju pyesja për këtë.

Kodheli: Pra, ne jemi plotësisht të përfshirë në këtë kohë të hartimit të buxhetit. Falë Zotit unë kam disa kolegë që janë ekspertë mjaft të mirë. Unë vetë po ashtu, gjë e cila nuk është domosdoshmërisht detyra e një ministri, kam për të kryer kontrole personalisht për shkak të të gjitha arsyeve që u rreka t'ju shpjegoja. Kjo është tej mase e rëndësishme sepse ne kemi nevojë të përmbushim disa detyrime dhe njëri prej tyre është se trupat tona duhet të modernizohen, duhet të mbështeten me pajisje moderne, e kam fjalën për trupa që në përgjithësi janë të përgatitura për të shkuar në Afganistan dhe jo vetëm, por edhe në misione të tjera paqeruajtëse.

Bugajski: Dhe të jenë ndërvepruese me trupat e tjera!

Kodheli: Natyrisht! Ato duhet të jenë në të njëjtin nivel e të kenë të njëjtën përgatitje që nga pajisjet e në gjithçka që atyre u duhen. Pra, kemi shpenzime që duhet t'i bëjmë medoemos, por ne mund të gjejmë mënyrën për t'i bërë ato si mos më mirë. Ne jemi këtu për të bërë pikërisht këtë gjë, sepse njerëzit na dhanë votën, gjithashtu për ta bërë këtë në një mënyrë më të mirë. Dhe kjo është njëra nga gjërat që ne kemi për t'u treguar atyre, me më pak para, ne mund t'ia dalim mbanë.

Bugajski: Evropa dhe Amerika përballen me të njëjtin problem: buxhet më të vogël, riorganizim më të madh, ministri të mbrojtjes dhe rrjete ushtarake më efikase, pra, them se Shqipëria s'është e vetme në këtë orvatje. Më lejoni t'ju bëj një pyetje specifike. Kur ju ishit në opozitë, socialistët kritikuan Ministrinë e atëhershëm të Mbrojtjes mbi çështjet e korrupsionit, shitjes dhe transferimit të pronave të ushtrisë, etj., një problem specifik, i cili kishte të bënte me Shtëpinë Qendrore të Ushtrisë që iu dha PD mbas zgjedhjeve. Çfarë ka për të ndodhur me këto çështje, si kjo që ju përmenda?

Kodheli: Siç e ceka më parë, ushtria zotëronte prona të shumta më parë. Disa gjendeshin në vende mjaft të këndshme, ose në disa pjesë strategjike e delikate të Shqipërisë dhe gjithashtu edhe në qendër të Tiranës. Ne patëm një diskutim të madh kur ishim në opozitë, jo vetëm mbi faktin se si trajtoheshin këto prona, por po ashtu mbi të gjithë procesin korruptiv në të cilën ato u

dhanë, apo u shitën, apo u nxorën në ankand. Pra, ka për të patur një diskutim të madh dhe ne kemi për t'i kontrolluar një nga një të gjitha rastet, natyrisht, duke i bërë auditim, duke i inspektuar dhe në fund të historisë, transparenca është gjëja më e mirë që mund të ndodhë kësokohe. Ne do t'u tregojmë qytetarëve nëse pronat e tyre, meqenëse ato janë prona të përbashkëta, përdoren nga njerëzit e duhur apo njerëzit e gabuar, shiten në mënyrën e duhur, apo në mënyrën e gabuar, janë dhuruar si pronë e përbashkët, apo sikur të ishin prona të qeverisë, gjë që përbën një ndryshim të madh, pra, nëse prona është e jona apo e qeverisë. Ajo duhet të jetë gjithmonë e jona, kështu që ne duhet të jemi vërtet transparentë kur kalojmë pronësinë nga njëra palë te tjetra. Në rastin specifik, parimisht, unë s'jam kundër faktit që një pronë e përbashkët të kalojë nga Ministria e Mbrojtjes tek një organizatë tjetër publike, siç është rasti i një partie, problemi qëndron tek procedurat, tek transparenca, pra kjo është më e rëndësishmja. Nëse s'ka procedura, nëse s'ka transparencë, nëse s'ka ligj ku këto procedura janë bazuar, nëse gjithçka është kundër gjithçkaje ligjore, këtu ne kemi një problem të madh. Edhe diskutimet tona, madje që përpara se unë të merrja detyrën, fokusoheshin pikërisht në këtë pikë: përse ata duhet të ndërtonin mure kaq të mëdha ndërmjet tyre dhe publikut, ndërmjet tyre dhe medias, ndërmjet tyre dhe njerëzve që janë të interesuar të dinë se këto prona s'po shiten si torta, s'po shiten për interesa mjaft të ngushta, por ato po përdoren për interesa të përbashkëta. Kjo është pika ku fundja fundit ne duhet të fokusohemi: interesi i përbashkët.

Bugajski: Më lejoni t'ju bëj një pyetje mbi korrupsionin, më saktë mbi politizimin. A do të thonit se ushtria shqiptare në tërësi është plotësisht e depolitizuar sipas standardeve të NATO?

Kodheli: Aspak! Përkundrazi!

Bugajski: A mund ta shpjegoni!

Kodheli: Shikoni, do të na duhej një orë e tërë për ta shtjelluar, por unë po përpiqem ta them shkurtimisht. Në gjirin e Forcave të Armatosura (FA) dhe të Ministrisë së Mbrojtjes ka pasur shumë trysni lidhur me faktin se ai që s'voton për PD, nuk është pjesë e jona. S'mund të jetë kurrsesi kështu. Ne do t'i vëmë fre kësaj gjëje njëherë e mirë. Ushtria është ushtri. Ajo ekziston që të mbrojë integritetin e Shqipërisë, që të mbrojë demokracinë e Shqipërisë, që të mbrojë pronat e qytetarëve, që të mbrojë gjithçka në të mirën e të ardhmes sonë. Pra, ushtria s'ekziston për të treguar nëse ushtarakët kanë votuar për PD apo PS, apo për parti të tjera. E dyta, ka shumë korrupsion, jo vetëm kur diskutojmë mbi pronat apo mbi tenderat apo ankandet apo mbi çdo aktivitet ekonomik që Ministria e Mbrojtjes ka në kornizën e saj, por gjithashtu edhe kur flasim për karrierën, e cila është një temë tjetër që ne do ta ballafaqojmë dhe me të cilën unë ballafaqohem që tani. Po them vetëm një gjë: paraardhësi im kishte vendosur disa yje në spaletat e disa gjeneralëve apo kolonelëve të FA në muajin maj, një muaj para zgjedhjeve, me ligj procesi duhet të përfundonte në shtator.

Bugajski: Shtatorin e kaluar!

Kodheli: Jo, këtë shtator! Pra, ata nxituan që të vendosnin disa yje shtesë në karrierën e dikujt vetëm për të pasur disa vota më tepër, sepse unë s'shoh asnjë arsye tjetër. Dhe kjo s'është e vetmja me të cilën unë po përballem. Ka një mori gjërash! Por...ka një "por" të madhe... Ne jemi

me fat që kemi në gjirin e ushtrisë shqiptare dhe të Ministrisë së Mbrojtjes edhe profesionistë dhe njerëz të mirë, të cilët respektojnë ligjin dhe Kushtetutën dhe të cilët respektojnë të gjitha llojet e procedurave. Pra, në këtë rast, ka akoma një mori nëpunësish civilë apo ushtarakë që i mbajnë Forcat e Armatosura të Shqipërisë dhe Ministrinë e Mbrojtjes ashtu siç duhet të jetë. Pra, në këtë rast, them dhe shpresoj që puna ime ka për të qenë më e lehtë, por ka shumë punë për të bërë. Diçka që duhet ta përmend medoemos është fakti se korrupsioni ka prekur edhe Shërbimin Informativ dhe madje tejet negativisht. Ka raporte konfidenciale ndërmjet shërbimeve të inteligjencës të anëtarëve të NATO, dhe nëse dikush nga jashtë mëson se ka korrupsion, atëherë ky mund të jetë një problem tejet i rrezikshëm dhe i madh. Pra, agjensia që po merret me shërbimin informativ brenda Ministrisë së Mbrojtjes duhet të ristrukturohet dhe riorganizohet sipas standardeve të NATO dhe lufta kundër korrupsionit ka për ta bërë atë një shërbim më të mirë e më efikas.

Bugajski: Paskeni goxha punë gjatë mandatit tuaj në detyrë! Më lejoni t'i kthehemi tani çështjes së NATO! Ju përmendët pak më parë rolin e Shqipërisë në Afganistan dhe planet pas tërheqjes së forcave të NATO-s...

Kodheli: Në 2014!

Bugajski: Pikërisht! Vitin tjetër! A mund të na jepni një tablo të kontributeve të Shqipërisë në Aleancë, përfshirë Afganistanin, por edhe në misione të tjera, në teatro të tjera?

Kodheli: Ne jemi një ushtri modeste, por ama gjatë këtyre viteve ne kemi shërbyer me rreth 5 mijë trupa në mbarë botën, i cili është një numër i madh krahasuar me numrin e ushtrisë që kemi, apo me numrin e qytetarëve!

Bugajski: Disa anëtarë më të vjetër të NATO kontribuojnë përpjesëtimisht po aq sa ju!

Kodheli: Po! Pra, ka më tepër se kaq. Trupat tona janë vlerësuar si nga më të mirat që kanë shkuar në front. Ky është lajm i mirë. Por ne jo vetëm, ne që kemi qenë pjesë e misioneve paqeruajtëse duke mos luftuar vetëm në vijën e parë të frontit, por sigurisht ne kemi edhe shumë gjëra të tjera për të bërë, p.sh., të përpiqemi të përmirësojmë strategjinë tonë në kornizën e strategjisë së NATO. Dhe diçka që ka shumë rëndësi, të cilën unë dua ta nënvizoj, është fakti se roli i Shqipërisë në përgjithësi, në aspektin politik dhe roli i ushtrisë shqiptare në Ballkan është një rol tejet i rëndësishëm. Pra, ne po përpiqemi të mbështesim vendet që duan të jenë pjesë e NATO në të ardhmen, si Mali i Zi, Maqedonia, apo Bosnja Hercegovina. Dhe sigurisht, të mbështesim rrugën e re që Brukseli hapi me marrëveshjen ndërmjet Serbisë dhe Kosovës, e cila natyrisht ka për të hapur perspektiva të reja për rajonin në përgjithësi dhe perspektiva të reja për të gjithë ne, pasi ne e dimë objektivin tonë dhe objektivi ynë është BE dhe strukturat euroatlantike. Pra, të gjithë ne duhet të punojmë bashkërisht, Shqipëria është një ndihmë dhe një përkrahje e madhe për të gjitha vendet që s'janë akoma në NATO, por gjithashtu të gjitha vendet duhet të japin një përkrahje të madhe për Shqipërinë në rrugën drejt BE. Rajoni tani është më i sigurtë dhe ne do të na pëlqente të përfitonim nga kjo situatë, e cila do të na ndihmonte tej mase të gjithë ne. Kjo është shumë e rëndësishme, sepse ne si shqiptarë kemi një rol tejet konstruktiv në rajon. Pra, kjo është tejet e rëndësishme, në kontekstin e NATO, ne kemi për të qenë një mbështetje shumë më e madhe. Them se, nga pikëpamja strategjike kjo është tejet e rëndësishme

për të gjithë ne dhe, natyrisht, ne duhet të përmbushim të gjitha detyrimet që kemi si vend anëtar i NATO. Por, në të njëjtën mënyrë, ne duhet të forcojmë funksionin e demokracinë brenda vendit tonë, gjë e cila ka për të na ndihmuar të kemi një vend të sigurtë, e kësodore ne mund të kemi më tepër investime të huaja në Shqipëri, duke patur kështu me tepër prosperitet, si dhe rezultate më të mira ekonomike, të cilat në këtë periudhë të krizës financiare janë vërtet një nga problematikat e mëdha me të cilat ne përballemi.

Bugajski: Ju përmendët vendet fqinje të Shqipërisë dhe tani ka zëra nëse Samiti i ardhshëm i NATO në Londër në vitin 2014 duhet të jetë apo jo një samit zgjerimi. Ka shumë konferenca dhe diskutime mbi këtë çështje. A besoni se ka një vend që është kualifikuar plotësisht për raundin tjetër, nëse do të kishte një raund tjetër në samitin e radhës?

Kodheli: Shikoni vendin tim! Vendi im është një shembull i mrekullueshëm se si një vend i vogël mund të bëhet anëtar i NATO. Axhenda e Samitit s'është botuar akoma, por ka mundësi të shumta që vende të tjera të bëhen pjesë e NATO. Them se në Samitin e Londrës ne do të diskutojmë sukseset që vendet anëtare të NATO kanë arritur tashmë, pozitën e anëtarëve të NATO në Afganistan, sepse atje do të përfundojë...

Bugajski: Misioni ka për të përfunduar!

Kodheli: Po, misioni përfundon dhe një tjetër mision ka për t'u hapur, them se kjo për të qenë pjesë e diskutimeve. Dhe sigurisht, përse jo zgjerimi! NATO ka politikën e dyerve të hapura, si të gjithë ne, por natyrisht, vende të tjera duhet të përballen me kërkesat e forta të NATO dhe këto kërkesa të forta duhet të përmbushen plotësisht, përndryshe zgjerimin e shoh si një çështje që do të shtyhet.

Bugajski: Zgjerimi ka qenë gjithnjë një lloj stimuli për NATO në 20 vitet e fundit, sidomos me shtetet e Evropës Qendrore dhe disa prej vendeve të Ballkanit. Sa i përket kualifikimit për në NATO, a do të thonit se Mali i Zi dhe Maqedonia, si dhe vende të tjera, janë mjaftueshëm të kualifikuara për të aderuar? Pra, a janë ata në nivelin e Shqipërisë kur vendi mori ftesën?

Kodheli: Pyetje e mirë! Nuk e di nëse përgjigja ime do jetë po aq e mirë, por ajo që unë di me siguri është fakti se po, ndoshta ato kanë përmbushur shumë prej kërkesave, por ama ka disa çështje politike që janë pjesë e këtij procesi. Maqedonia ka një problem me emrin, kurse Mali i Zi ka probleme të tjera politike në rrugën drejt NATO. Zgjidhja e tyre me siguri ka për të bërë që ato të jenë anëtarë të NATO. Kjo është e sigurtë! Pra, s'bëhet fjalë vetëm për zgjidhjen e problemeve teknike, por edhe të atyre politike. Kjo është arsyeja përse Ballkani po jeton tanimë në një mjedis mjaft të sigurtë, por jo atje ku ne do të dëshironim të ishim. Pa zgjidhur disa probleme midis nesh, unë s'besoj se kjo ka për të qenë një detyrë e lehtë. Pra, mbetet për t'u parë!

Bugajski: Drejt! Ju e dini se ka debate të mëdha si në Uashington, por edhe në Evropë mbi të ardhmen e NATO. Cili është qëllimi i Aleancës mbasi pjesa më e madhe e trupave të

kthehen në shtëpi në përmbyllje të misionit afgan? Çështja se sa e suksesshme, se sa larg zonës duhet të jetë NATO? A duhet të fokusohet ajo në misionin e saj thelbësor, me fjalë të tjera në mbrojtjen e ndërsjellë? Cila është pikëpamja juaj mbi këtë? Cila është e ardhmja e NATO?

Kodheli: Kërcënimet ndaj demokracisë e kanë ndryshuar fytyrën e NATO. Po! Akoma mund të diskutojmë mbrojtjen raketore, ose armët kimike dhe ato të shkatërrimit në masë, ose sigurinë kibernetike, sigurinë në energji. Të gjitha këto, ashtu si edhe terrorizmin, të cilat ndryshojnë dimension, ndryshojnë ngjyra, ndryshojnë mënyrën se si ato po kërcënojnë demokracitë tona, të dobëtat e të fortat. Them se NATO duhet të jetë e përgatitur për këto ndryshime të reja, për këto kërcënime të reja, pra, NATO do të jetë ende aty duke punuar e fokusuar mbi këto çështje. Për sa kohë që këto kërcënime do të ekzistojnë, shtetet anëtare dhe vetë NATO si organizatë duhet të jenë të përgatitur. Duhet të përgatisin civilët dhe trupat ushtarake për një mbrojtje të mirë. Dhe kjo është tejet e rëndësishme për të gjithë ne.

Bugajski: Duke iu kthyer edhe një herë çështjes së zgjerimit, them se ka lidhje me ato që po thoni. Misioni fillestar strategjik i NATO pas Luftës së Ftohtë ishte ta bënte Evropën të plotë, të lirë dhe të paqtë. Kjo ishte fraza e përdorur. Evropa nuk është ende e plotë, e lirë dhe e paqtë. Ka disa copëza të mozaikut, jo vetëm në Ballkan, por edhe në Evropën Lindore që s'janë anëtarësuar ende, as në NATO, as në BE. Cili është këndvështrimi juaj? A është Shqipëria dhe qeveria shqiptare e përkushtuar për t'i përfshirë një ditë të gjitha shtetet evropiane në NATO, sapo të plotësojnë kushtet? Përfshi Ukrainën, Gjeorgjinë e vendet e tjera?

Kodheli: Pse jo? Pse jo? Mendoj se është gjë e mirë. Ne do luajmë rolin tonë të vogël, por të mirë e intensiv në përpjekje për të anëtarësuar më shumë vende dhe shtete në këtë organizatë të madhe, e cila është krijuar që në fillim, siç e thatë edhe ju, që në Marrëveshjen e Atlantikut Verior në 1949 e largët, si një organizatë për të ruajtur paqen, sigurinë dhe prosperitetin e vendeve demokratike. Kjo është tepër e rëndësishme, sidomos për Evropën. Shumë prej vendeve janë të përgatitura për të hedhur hapa në drejtimin e duhur. Sigurisht, ka disa çështje politike me të cilat duhet të përballemi përgjatë kësaj rruge dhe njëra prej këtyre është padyshim ajo e vendeve të ish-Bashkimit Sovjetik, që kanë skenarët dhe mjedisin e tyre në atë pjesë të botës. Por do të më bëhej qejfi që të anëtarësoheshin sa më shumë vende në NATO e të kishim sa më shumë kapacitete. Kjo do të ishte një mënyrë e lehtë për të luftuar kërcënimet sa herë që ato shfaqen. Është gjë e mirë për mendimin tim, është gjë e mirë.

Bugajski: Ishte si një parapritë për pyetjen mbi Rusinë, e cila jo vetëm që ka qenë kundër zgjerimit të NATO, por edhe e vetë ekzistencës së NATO për vite me radhë. Në fakt, Moska dhe Medvedevi, por besoj se po përsëritet edhe nën udhëheqjen e Putinit, duan të shohin njëfarë Traktati të Sigurisë Evropiane, ku roli i Amerikës do ishte, në mos minimal, të paktën më i vogël, ku roli i Ruisë të jetë më i rëndësishëm në strukturën e sigurimit, e ku NATO të lihej mënjanë në shumë aspekte. Ç'mendim keni për propozimin dhe qëndrimin rus mbi NATO? A është realist?

Kodheli: Nuk mendoj se duhet ta komentoj. Them se nëse arrihet një marrëveshje, për shembull, në rastin e Ruisë, dhe kjo bazohet në Deklaratën e Romës, besoj, dhe në marrëveshjen tjetër me NATO, marrëveshjet duhen respektuar. Është gjë e mirë të bëhen diskutime, diskutime në nivele

të larta, të ketë ulje-ngritje, të japësh mendime, por kur arrin një marrëveshje, duhet ta respektosh. Ta respektosh pikë për pikë. Në këtë rast, këto janë marrëveshje të mira. Them se Rusia është një vend i madh e i rëndësishëm, ndaj arritja e një marrëveshjeje NATO - Rusi, është gjë e mirë, sepse ne, si anëtarë të NATO, dhe NATO si organizatë, kemi shumë gjëra të përbashkëta me Rusinë, si mburoja raketore, mbrojtja kundër terrorizmit, mbrojtje kundër sulmeve të tjera. Është gjë e mirë, sepse të gjithë ne duhet të jetojmë në një botë të sigurt. Kjo është tepër e rëndësishme.

Bugajski: Problemi është se Rusia bën lojën “fitorja e njërit është humbje për tjetrin”. Me fjalë të tjera ata kundërshtojnë edhe anëtarësimin e vendeve balltike në NATO, jo më të Ukrainës apo Gjeorgjisë. Nëse Gjeorgjia dhe Ukraina anëtarësohen në NATO, Rusia humbet! Si i përgjigjeni kësaj?

Kodheli: Duhet të ulen në tavolinë dhe t'i diskutojnë çështjet, sepse qeniet njerëzore janë të mirë kur diskutojnë, kur flasin me njëri-tjetrin, kur i shtrojnë çështjet në tavolinë, kur ulen e tregohen të hapur dhe pozitivë, pra, le të diskutojmë. Le të diskutojmë për të gjitha çështjet me të cilat realiteti aktual na përball, jo vetëm për të mirën e një vendi të vetëm, por për interesin e përbashkët, për interesin e të gjithëve, kjo është shumë e rëndësishme. Shikoni vendet balltike! Kanë goxha prosperitet, ekonomi të mira, janë vende të sigurta dhe kjo është gjë e mirë. Ku ishin ato dy dekada më parë? Shumë larg atmosferës ku ndodhen tani. Tani pas dy dekadash, edhe Ballkani është shumë larg për mirë. Pra, duhet kohë, ndoshta, por është e rëndësishme që të ketë diskutime mes palëve. Luftërat janë gjë e keqe jo vetëm për vendet ku ndodhin, por për të gjithë ne. Shikoni ç'po ndodh në Siri. Vendi është shndërruar në diçka që s'di si ta shpjegoj! Të vjen keq kur shikon ç'po ndodh atje. Dikur ka qenë një vend i këndshëm e i bukur, plot me histori.

Bugajski: Mendoni se NATO duhet të ndërhyjë?

Kodheli: Them se hapi i parë ishte i mirë. Zhvendosja e armëve kimike dhe armëve të shkatërrimit në masë nga zonat ku janë, që askush mos të ketë mundësinë t'i përdorë, është hap i mirë. Është një hap i parë, i dobët, por ama shumë i mirë. Më vonë të shohim.

Bugajski: Shtrohet çështja nëse NATO, ose një pjesë e NATO, ose ndonjë aleancë në kornizën e NATO duhet të përfshihet në luftëra civile, në promovimin aktiv të demokracive, në ndryshimin e regjimeve, siç e quajnë në disa pjesë të botës. Ç'qëndrim mban Shqipëria?

Kodheli: Nëse do të luftojmë për demokraci, duhet të luftojmë. Mënyra mund të jetë e ndryshme, në vende e kohë të ndryshme, por ia vlen të luftosh për demokracinë, sepse demokraci do të thotë shumë gjëra: siguri për të ardhmen, ekonomi e mirë, prosperitet për të gjithë ne. Unë jam në favor të demokracisë. Mënyra si do e mbështesësh demokracinë apo sigurinë e një vendi, kjo varet. Në këtë rast, siç e thashë edhe më parë, kemi bërë një hap të parë të mirë, shkatërrimi i armëve kimike të të gjitha llojeve; së dyti, duhet të ulemi dhe të bisedojmë dhe ndoshta të arrijmë edhe në një zgjidhje tjetër pa qenë nevoja e ndërhyrjes ushtarake, e cila me gjasë do të jetë një mënyrë e mirë e të bërit të gjërave, por, le të shohim. Padyshim që varet nga reagimi i Qeverisë së Asadit dhe, jo vetëm, ndikojnë edhe faktorë të tjerë ndërkombëtarë.

Bugajski: Unë do thoja që pjesë e problemit në këto vende nuk është një tablo bardhezi, pra, të këqijtë kundër të mirëve, sepse jo të gjithë kundërshtarët e Asadit, siç e kemi parë, janë domosdoshmërisht demokratë model apo demokratë të rinj. Në radhët e rebelëve ka një pjesë që janë islamistë autoritarë, në mos fashistë. Problemi është se po vriten shumë njerëz të pafajshëm. Si do ndërhynte NATO, si do të gjenden mënyra diplomatike apo të tjera për të sjellë në pushtet demokratët dhe të ndalohet masakrimi i civilëve? Kjo është çështja kryesore.

Kodheli: Situata atje është paksa e ndërlikuar. Problemi është që, nëse demokracia s'është funksionale në një vend dhe nëse dikush që drejton vendin sillet si diktator, atëherë, dikush tjetër duhet t'i tregojë atij që ai duhet të sillet ndryshe. Ky është thelbi. Sigurisht, ka shumë mënyra për t'ia treguar, ka shumë mënyra se si mund ta trajtosh çështjen e të angazhohesh dhe të arrish marrëveshje me këtë regjim. Dhe mënyra më e mirë është të ulësh në bisedime, që ata të kuptojnë që ndoshta ka ardhur koha që Siria të zhvillojë zgjedhje të lira, të ketë më tepër hapësirë për pluralizëm dhe natyrisht, tani ka ardhur koha që të mos vrasin popullin e tyre dhe të mos përdorin dhunë kundrejt popullsisë së tyre, por jo vetëm. Ka ardhur koha t'i japin fund. Ka ardhur koha të tregojnë që Siria mund t'ia dalë mbanë me ndihmën e NATO, natyrisht, dhe me ndihmën e OKB dhe faktorëve ndërkombëtarë.

Bugajski: Besoj se gjëja e rëndësishme është që të mos fokusohemi vetëm tek armët kimike, sepse shumë civilë janë vrarë nga armët konvencionale. S'duhet ta lënë me kaq, që ai të dorëzojë, besoj në një afat të gjatë kohor, vetëm arsenalin e armëve kimike. Personalisht mendoj se Rusia po e mbron regjimin e tij dhe do vazhdojë ta bëjë dhe, kjo ishte vetëm një taktikë për ta mbajtur Asadin në pushtet.

Kodheli: Jam e bindur që njerëzit janë ulur dhe kanë biseduar në periudha të ndryshme të jetës dhe kanë zgjidhur çështje shumë më të ndërlikuara se ajo e Sirisë. Ka ardhur koha të mos harxhojmë më tepër përpjekje dhe energji dhe të mos humbasin jetë të tjera civilësh, sepse është një turp për të gjithë njerëzimin.

Bugajski: Për sa i përket politikës shqiptare, nëse i marrim çështjet me radhë, a ka konflikte të ardhshme ku duhet të ndërhyjë NATO?

Kodheli: Po, sigurisht, por kjo është pjesë e situatës politike në çdo rast, gjë e cila mund të ndryshojë për shkak të shumë ngjarjeve ndërkombëtare. Natyrisht, revolucionet e Afrikës së Veriut kanë ndikuar në politikën tona të jashtme dhe natyrisht edhe vendimet që ne marrim në përputhje me vendimet e NATO. Ky është një mësim i madh për ne, një mësim i madh. Gjërat mund të ndryshojnë rrënjësisht krejt papritur. Pra duhet të jemi gati, dhe kjo ka rëndësi. Shqipëria është shumë afër, madje është pjesë e Mesdheut, ndaj duhet të veprojmë me mjaft kujdes në fushën politike, në diskutimet e politikës së jashtme dhe çështjeve politike, madje, edhe atyre ushtarake. Sigurisht, t'u bashkohemi vendimeve të NATO dhe të ndihmojmë NATO në çdo veprim që do të ndërmarrë. Por ne jemi, ndonëse vend i vogël, një katalizator mjaft i mirë i asaj që ndodh rreth e rrotull, sepse Shqipëria, për shkak të pozicionit të saj strategjik dhe gjeografik, është në kufirin ndarës mes lindjes dhe perëndimit. Ka qenë gjithnjë e tillë. Është gjë e mirë për ne, sepse na bën të ndihemi qytetarë të botës, e jo vetëm pjesë e Evropës. Ne kemi

qenë pjesë e shumë perandorive përgjatë historisë. Që nga ajo romake, bizantine, në atë otomane...

Bugajski: Në atë sovjetike dhe kineze...

Kodheli: Në atë sovjetike dhe kineze... Them se më në fund jemi pjesë e demokracive përëndimore, por edhe pse kemi demokraci të brishtë në vendin tonë, ne duhet të shikojmë përpara dhe të luftojmë për një demokraci më funksionale, sepse kjo është tepër e rëndësishme, tepër themelore.

Bugajski: Siguria nis nga shtëpia. Më lejoni t'ju bëj një pyetje. Siç thatë, dhe jam dakord me ju, gjërat mund të ndryshojnë e të përkeqësohen shumë shpejt. A vlen kjo edhe për fqinjët rreth e rrotull? A shihni ende rreziqe në rajonin e Ballkanit mes fqinjve? Me fjalë të tjera, a mundet ndonjë konflikt i brendshëm të çojë në një krizë ndërkombëtare?

Kodheli: Jo, nuk besoj. Përkundrazi! Jo rastësisht, NATO dhe BE kërkojnë procese paraprake vlerësimi për t'u bërë vende kandidatë. Ata kërkojnë përmbushjen e disa pikave, njëra prej të cilave është integrimi i Ballkanit dhe marrëdhënie të mira fqinjësore mes vendeve të Ballkanit. Kjo është mjaft e rëndësishme. Duhet ta marrim mësimin. Them se Ballkani e ka marrë tashmë këtë mësim sepse shumë prej vendeve ballkanike kanë dalë nga një luftë e përgjakshme në më pak se 15 vjet më parë, të cilën të gjithë ne e mbajmë mend. Për të ecur para, ne duhet të veprojmë bashkërisht, sepse do të ecim në të njëjtën rrugë dhe, nëse e bëjmë këtë rrugë bashkërisht, e kemi të gjithë më të lehtë që të arrijmë objektivat. Pra, jo, unë besoj se Ballkani është një rajon i sigurt.

Bugajski: Sa i përket mjedisit të Ballkanit, ç'këndvështrim keni për propozimin Ballkani-6, B-6, nga Mali i Zi? Me fjalë të tjera, cilat janë mundësitë dhe kufizimet e bashkëpunimit rajonal? Disa nga vendet fqinje kanë thënë që "s'duam të krijojmë një Jugosllavi të re", "duam të bëhemi pjesë e Evropës, pjesë e NATO-s". Cili është këndvështrimi juaj? Nëse materializohet, a mund të përmbajë ndarjen e aseteve të sigurisë, a mund të përfshijë çështje të mbrojtjes së përbashkët në rajon?

Kodheli: S'mendoj se një Jugosllavi e re do të krijohet! Kurrsesi! Ne do të donim të ishim nën një çadër të vetme, nën çadrën e BE dhe ndoshta, sigurisht, nëse bëhet fjalë për Ballkanin, edhe nën çadrën e NATO. Kjo do të thotë që këto organizata do jenë një ndihmesë e madhe për ne, por edhe që ne duhet të përmbushim disa detyrime. Që t'i përmbushim detyrimet, ne mund të kemi marrëveshje rajonale, marrëdhënie të forta rajonale, sigurisht që duhet t'i kemi dhe mund t'i krijojmë. Por kjo do të arrihet gjithmonë, sipas meje, nën këto dy çadra të mëdha, të cilat janë aq të mëdha sa të na përfshijnë të gjithëve dhe të na shpien në një kahje të caktuar, që është demokracia dhe tregu i lirë. Këto janë dy temat kryesore: demokracia dhe tregu i lirë. Lokale ose jo, ballkanase ose jo, rajonale ose jo, sigurisht, ne kemi marrëdhënie të forta mes nesh dhe do vazhdojmë t'i kemi, diçka e tillë është krejt normale, jo vetëm në fushën ekonomike...

Bugajski: Por jo në struktura të reja ndërkombëtare ?

Kodheli: Jo, aspak.

Bugajski: Harrova t'ju bëja një pyetje kur folëm për zgjerimin. Besoj se Shqipëria mbështet anëtarësimin e Kosovës në NATO, sapo vendi të përmbushë kushtet ?

Kodheli: Po. Ne do ta mbështesim Kosovën. Është krejt normale. Por ata kanë bërë hapa të jashtëzakonshëm përpara. Më vjen mirë për ata. Po punojnë fort për të përmbushur kushtet dhe shpresoj që të anëtarësohen sa më shpejt...

Bugajski: Sa mendoni se do të zgjasë procesi?

Kodheli: Do zgjasë paksa, por është e natyrshme. Them se ata po bëjnë gjënë e duhur dhe kjo është më e rëndësishme se kohëzgjatja. Ne do t'ju gjendemi pranë. S'jemi të vetmit që i mbështesin në këtë rrugë. Shumë vende të tjera, jo vetëm në rajon dhe natyrisht, partneri ynë kryesor strategjik, SHBA, po e mbështet shumë Kosovën, siç bënë edhe me Shqipërinë.

Bugajski: Atëherë, besoj se do mbështesni edhe anëtarësimin e Serbisë në NATO?

Kodheli: Po sigurisht, kështu duhet të ndodhë. Ndonëse Serbia është partnere e NATO, por nuk merr pjesë në misionet e drejtuara nga NATO. Por jam e sigurt që nga ana e tyre ata do të japin maksimumin që të ecin drejt anëtarësimit në BE, që për ta është një çështje me tepër rëndësi, dhe sigurisht, edhe në proceset e anëtarësimit në NATO. Për Serbinë këto çështje janë po aq të rëndësishme sa për të gjitha vendet e Ballkanit.

Bugajski: Një tjetër pyetje lidhur me fqinjët... Mbarojmë pas disa minutash dhe më kanë mbetur edhe disa pyetje. Një tjetër çështje e fqinjësisë është roli i Turqisë. Shqipëria ka një partneritet strategjik me Turqinë. Vizita e Ministrit të Jashtëm turk para disa kohësh në Tiranë. Cili është këndvështrimi juaj për marrëdhëniet Shqipëri-Turqi? Sa të rëndësishme janë ato? Sa strategjike?

Kodheli: Janë si të rëndësishme, ashtu dhe strategjike, të dyja do thoja. Së pari, sepse Turqia është anëtare e NATO; së dyti, sepse ne kemi një histori të gjatë të përbashkët dhe ne, siç jam e sigurt se e dini edhe ju, por duhet thënë për shikuesit tanë..., në Turqi jetojnë miliona shqiptarë. Po! Turqia do të jetë një partner i rëndësishëm strategjik i yni, jo vetëm ushtarakisht, por edhe politikisht dhe ekonomikisht. Ata na kanë mbështetur së tepërmi në Ministrinë e Mbrojtjes, dhe kanë dhënë ndihmesën e tyre edhe në Forcat e Armatosura me trajnime, me ndihma mjekësore, me pajisje dhe ky partneritet do vazhdojë, sepse kemi marrëdhënie fort të mira me ta.

Bugajski: Shkojmë pak më tej, me planin e ri të energjisë, gazsjellësin TAP, që kalon nga Azerbajxhani në Anadoll, në Greqi, në Shqipëri e më pas në Evropë. Ky projekt ju afron edhe me disa prej vendeve të Kaukazit, sidomos me Azerbajxhanin. A mendoni se kjo marrëdhënie po zhvillohet pozitivisht?

Kodheli: Po, sepse nëse diçka ka vlerë nga pikëpamja ekonomike, atëherë është gjithmonë pozitive. Pra, po, popujt mund të lidhen jo vetëm nga ngjashmëritë kulturore, apo të qenit fqinj, por edhe me anë të një gazsjellësi. Kjo është teknologjia e re, kjo është epoka e re në të cilën po jetojmë dhe është një gjë e mirë. Them se për ekonominë shqiptare, kjo do jetë një nga ngjarjet

më të rëndësishme. Të gjithë duhet të jemi të kënaqur me këtë projekt dhe në këtë rast nuk di kë duhet të falënderoj, ndoshta Zotin, që rajoni ynë është kaq i pasur me gaz natyror apo me burime të tjera, që mund të na ndihmojnë për një performancë më të mirë ekonomike, por jo vetëm. Kjo miqësi e re, nëse mund ta quaj kështu, me vendet e Kaukazit është gjë e mirë për ne, e me sa më tepër tregje ke të bësh, aq më mirë është.

Bugajski: Sa më tepër diversitet të ketë...

Kodheli: Sa më tepër diversitet të ketë portofoli ekonomik, aq më mirë është. Është gjë e mirë për Shqipërinë, siç është gjë e mirë edhe për vendet e tjera ku kalon gazsjellësi.

Bugajski: Është gjë e mirë edhe për Azerbajxhanin. Për arsye strategjike?

Kodheli: Po, sigurisht. Po, por lum ata që kanë burime të tilla, gaz e të tjera dhe lum ne që kemi një pozitë të mirë gjeografike. Lum edhe të tjerët që kanë burime të tjera të mira. Ndaj, diversiteti e bën botën më të këndshme dhe më të bukur. Dhe kjo duhet të na ndihmojë të gjithëve, jo të bëhemi armiq, por miq të mirë.

Bugajski: Pyetja e fundit, Mimi. Sa i madh është bashkëpunimi mbrojtës mes Shqipërisë dhe SHBA? Mendoni se ka fusha në të cilat mund të shtohet, të përmirësohet, të zhvillohet akoma më tej? Cilat janë planet e administratës socialiste?

Kodheli: Jam shumë e bindur që Qeveria Rama do e mbështesë idenë e pasjes së SHBA si partneri strategjik më i madh dhe më i rëndësishëm. SHBA na ka ndihmuar së tepërmi në hartimin e dokumenteve strategjike të mbrojtjes, në përpjekjet për të modernizuar dhe ristrukturuar ushtrinë, në trajnimin e personelit, qofshin ushtarakë ashtu dhe civilëve, në mbështetjen në misionet tona në Afganistan, në mbështetjen me pajisje të ndryshme, në mbështetjen e procesit të demilitarizimit dhe, sigurisht, përmes mbështetjes që na ofron ambasada amerikane në Tiranë. Dua të falënderoj në veçanti ambasadorin Arvizu për këtë, por edhe zyrën që mbështet Ministrinë e Mbrojtjes dhe mua në veçanti, "CUBIC Team". Para dy javësh firmosëm një marrëveshje tepër të rëndësishme me Akademinë Ushtarake të Nju Xhersit. Njerëzit tanë do kryejnë trajnime të rëndësishme atje dhe do përgatiten si udhëheqës kur të kthehen, ose do të përgatiten për të qenë ushtarakë të zotë. Do doja të bëja një falënderim për SHBA për gjithçka që ka bërë me paratë e taksapaguesve amerikanë, siç do doja të siguroja taksapaguesit shqiptarë që paratë e tyre do shpenzohen në mënyrën e duhur, në mënyrë efikase, jo në mënyrë abuzive dhe, në këtë rast, transparenca do të përmirësohet. Ata do të kenë mundësinë të dinë më mirë se ç'po bën Ministria e Mbrojtjes. Pse ekziston ushtria shqiptare dhe përse harxhojnë 1.3% të PBB në këtë fushë. Të qenit transparent ka një domethënie të madhe për demokracinë dhe kjo është ajo që ne do të bëjmë.

Bugajski: Bukur! Mimi Kodheli, faleminderit për mendimet e tua! Faleminderit që ishit në studio! Jam i bindur që do jeni sërish e ftuar dhe ju lutem, çlodhuni pak se ju pret një portofol mjaft i ngjeshur gjatë viteve në vazhdim.

Kodheli: Do përpiqem. Faleminderit!